



AKADEMIA E TË RINJVE E SHQIPËRISË ALBANIAN YOUNG ACADEMY

Tiranë, më 22 shtator 2017

Thirrje për pjesëmarrje në konferencën: "Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi"

Akademia e të Rinjve e Shqipërisë, me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizon konferencën e parë mbarëkombëtare shkencore të kërkuesve të rinj me temë: **"Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi"**.

Konferenca do të zhvillohet në datat **4-5 dhjetor 2017**, në kuadër të vep-
rimitarive për festimin e 45 vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të
Shqipërisë dhe promovimit të Akademisë së të Rinjve, si organizëm i ri shkencor
në Shqipëri. Përmes propozimeve dhe diskutimeve, konferenca synon të çojë
përpara debatin shkencor për një çështje kaq gjithëpërfshirëse dhe aktuale për
studimin shkencor.

Më konkretisht, në Konferencën II të Përbashkët Shkencore të Procesit të
Ballkanit Perëndimor, që u mbledh pranë Akademisë Austriake të Shkencave nga
data 22-24 maj 2016, ndër të tjera u rekomandua që *"Sistemet e shkencës dhe
të arsimit të lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë përpjekje për
të qenë të hapura. Ato lipset të ndjekin metoda të reja kërkimore dhe të
përdorin koncepte të reja organizative"*.

Kërkimi shkencor në Shqipëri ka pësuar një ndryshim të thellë në shumë
aspekte. Ndër më të rëndësishmit janë metodat kërkimore të zbatuara dhe
metodologjitë e studimit si në shkencat shoqërore, ashtu edhe në ato natyrore e
teknike. Një pjesë e kërkimeve ende realizohen me metoda dhe qasje
interpretuese tradicionale, edhe pse prirja mbizotëruese është "reformimi"
metodologjik. Kjo ka sjellë, në mënyrë të natyrshme, evidentime të fakteve të

reja, analiza të tjera, qëndrime të tjera shkencore, interpretime të tjera, në kërkim të së vërtetës shkencore. "Vërshimi" i lirë i metodave kërkon, më së pari, edhe një diskutim në lidhje me to, për të qartësuar, përzgjedhur e braktisur metoda të caktuara, që nuk i përgjigjen realitetit të zhvillimit në Shqipëri. E për këtë, mendojmë se është e rëndësishme të diskutohet për çështje që lidhen me:

- Prurje të reja metodologjike në shkencat shoqërore dhe natyrore e teknike.
- Aspekte të kërkimit sasior dhe cilësor, metoda, teknologji, analiza të të dhënave, kampionimi, evidentimi i fakteve.
- Metodatat tradicionale të kërkimit: aspekte pozitive e negative.
- Fusha të kërkimit të përmirësuara metodologjiksht.
- Metodologjinë dhe kërkimin shkencor në institucione publike apo private.
- Metoda kërkimi ndërdisiplinore.
- Realitete të bashkëpunimit mes disiplinave shkencore tradicionale dhe bashkëkohore.
- Struktura të paraqitjes së kërkimit shkencor.

Thirrja për pjesëmarrje në këtë konferencë është e hapur për gjithë kërkuesit e rinj nën **moshën 45 vjeç**.

Gjuhët e referimit në konferencë do të jenë shqipja dhe anglishtja.

Abstraktet dhe artikujt e plotë duhet të jenë në shqip dhe në anglisht.

Aktet e konferencës do të botohen në dy gjuhë (shqip & anglisht), në numrin e parë përurues të revistës periodike të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë. Po ashtu, ato do të publikohen në faqen e internetit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

UDHËZIME PËR PËRMBLEDHJEN (ABSTRAKTIN)

Fusha e kërkimit: autori duhet të përcaktojë fushën e studimit të tij, disiplinën shkencore ku përfshihet referimi.

Titulli: Titulli duhet të jenë në shkronja të trasha në Times New Roman, madhësia 12.

Emri i autorit: përmbledhja duhet të përfshijë emrin, titullin, institucionin, numrin e telefonit, adresën e emailit.

Teksti i përmbledhjes: Teksti me shkronja 12, Times New Roman, jo shkronja të trasha, me një hapësirë mes shkronjave, deri në 400 fjalë.

Fjalët çelës: në Times New Roman, madhësia 12, jo më shumë se 10 të tilla, me shkronja të pjerrëta (italik)

Abstrakti do të përbëjë bazën për shqyrtimin e çdo propozimi dhe miratimin e tij. Të gjitha abstraktet do të shqyrtohen nga anëtarët e komisionit organizator të konferencës.

UDHËZIME PËR ARTIKULLIN E PLOTË

Artikulli: jo më i gjatë se 12 faqe A4.

Fjalët çelës: jo më shumë se 6 të tilla, Times New Roman, madhësia 12, me shkronja të pjerrëta (italik)

Formati i tekstit: Hapësira anës shkrimit 2.5 cm; hapësira mes rreshtave single-spaced.

Madhësia e shkronjave: 12-pt, Times New Roman

Referencat: Në tekst, me numra vijues

Propozimet për këtë konferencë duhet të dorëzohen brenda datës **31 tetor** në adresën elektronike albya@akad.gov.al

Komisioni organizativ